

VENDIM
Nr. 113, datë 6.3.2019

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE QË PËRFAQËSOJNË PALËN SHQIPTARE NË
KOMISIONIN SHQIPTARO-MALAZEZ PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE ME
INTERES TË PËRBASHKËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të kreut III, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve që përfaqësojnë palën shqiptare në komisionin shqiptaro-malazez për menaxhimin e ujërave me interes të përbashkët, në zbatim të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për marrëdhëniet e ndërsjella në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare, miratuar me vendimin nr. 745, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, të përbërë, si më poshtë vijon:

a)	Znj. Gerta Lubonja, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	kryetar;
b)	Z. Arben Mukaj, Ministria për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	anëtar;
c)	Znj. Mira Hoxha, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	anëtar;
ç)	Z. Astrit Shatro, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit	anëtar;
d)	Z. Kristaq Qirko, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor	anëtar;
dh)	Z. Ermal Kacurri, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare	anëtar;
e)	Z. Arben Pambuku, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	anëtar;
ë)	Z. Neritan Postoli, Agjencia Kombëtare e Mjedisit	anëtar;
f)	Z. Maksimiljan Dhima, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, në Ministrinë e Mbrojtjes	anëtar;
g)	Z. Arduen Karagjozi, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	anëtar.

2. Punët administrative për nevojat e komisionit, për palën shqiptare, do të kryhen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

3. Anëtarët e komisionit shqiptaro-malazez për menaxhimin e ujërave me interes të përbashkët raportojnë, në mënyrë periodike, për veprimtarinë e tyre pranë Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe